


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	18.12.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-02-4095/15
PËR/ZA/TO:	z. Visar Haxhibeqiri – Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



I nderuari z. Haxhibeqiri,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj me numër protokoli DPKI 03-02-4095/15, për marrjen e një mendimi për zyrtarin e lartë publik z. Ilir Salihu - Shef i kabinetit të Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë dhe emërimi eventuale i tij në pozitën e Anëtarit të Bordit Drejtues në Kompaninë e Sigurimeve “Kosova e Re”, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ushtrimi këtyre funksioneve njëkohësisht paraqet mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Arsyetim

Në bazë të Ligjit 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik pozita e Shefit të kabinetit, hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë publik.

Sipas këtij ligji, të gjithë zyrtarët e lartë publik kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit dhe kanë për detyrë të zgjidhin vetë brenda afatit ligjor, dhe në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tyre të interesit (neni 8, par. 1).

Për këtë rast kemi analizuar Rregulloren nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të sigurimit e të Ndërmjetësuesve të Sigurimit, si dhe Statutin e Kompanisë “Kosova e Re”, i cili është dokument bazë që rregullon fushë veprimtarinë e kësaj kompanie.

Prandaj, kemi vlerësuar se ushtrimi njëkohësisht i funksionit të Shefit të Kabinetit të Ministrit të Tregtisë dhe Anëtarit të Bordit në Kompaninë e Sigurimeve “Kosova e Re”, bie në kundërshtim me nenin 15 (pika 1) të Ligjit 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, në të cilin përcaktohet se:

Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private.

Andaj, duke pasur parasysh këtë dispozitë kjo situatë konsiderohet mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, që rrjedhimisht z. Ilir Salihu nuk i lejon njëkohësisht ushtrimin e këtyre dy funksioneve.

Me respekt!